KËRKESË
Nr.109/1, datë 15.11.2007

Shpallje kërkese për shpronësim publik

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të pusit të ujit nr.3 Vrion dhe lidhjes me tubacionin e ujësjellësit të Navaricës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Sarandë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruar me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË PUSIT TË UJIT NR.3 VRION DHE LIDHJES ME TUBACIONIN E UJËSJELLËSIT TË NAVARICËS

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m^2	Vlera në lekë
1.	Haramb Koci Papa	750 m^2	320	240 000
2.	Jani Koci Papa	850 m^2	320	272 000
	Shuma	1 600	320	512 000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 512 000 lekë (pesëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.